

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

**Auditim i avancuar dhe
siguria
(zgjidhjet)**

P10

Data 20/01/2018

Detyra 1

Ju jeni menaxher i auditimit në firmën RAR Audit. Jeni duke planifikuar të filloni me auditimin e kompanisë EuroTar për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017. EuroTar ka 12 dyqane në Prishtinë dhe 35 të tjera në tërë Kosovën. EuroTar është kompani që shet mallra me nga 1 Euro Gjithçka. Dyqanet e para të kompanisë u hapën në vitin 2004 dhe RAR Audit ishte auditor që nga viti 2007. EuroTar operon me marzha të vogëla të fitimit prandaj ka vendosur theks të veçantë në kontrollimin e shpenzimeve. Fitimi bruto është luhatur në mes të 36.7% dhe 37.2% brenda 5 viteve të fundit. Luhatjet marxhinale në përqindje të fitimit bruto prej 0.1% ose 0.2% konsiderohen domethënëse për kompaninë. Viti i sapo përfunduar nuk ishte vit i mbarë për kompanitë e shitjeve me pakicë. Kompanitë e mëdha me pakicë e fajësonin qarkullimin e dobët të konsumatorëve gjatë vitit për shkak të gjendjes ekonomike por gjithashtu edhe për shkak të rritjes së shitjeve online të disa operatorëve tjerë. Për EuroTar situata ishte edhe më e vështirë. Edhe pse gjatë vitit kishin filluar me shitjen online të produkteve, kjo nuk kishte ndikuar në rritjen e shitjeve. Kohë pas kohe, kompania ka rritje të shkurtër të shitjeve me rastin e shitjeve të produkteve aktuale të modës siç janë shkopinjtë për selfie ose rrotulluesit fidget. Fatëkeqësisht këtë vit kompania nuk pati raste të tilla të rritjes së shitjeve të përkohshme. Stoqet e kompanisë konsiderohen si një fushë veçanërisht me rrezik të auditimit. EuroTar angazhon një kompani profesionale për të numëruar stoqet shpejtë dhe në mënyrë efikase.

Kompania e numërimit të stoqeve ka dërguar nga një ekip të numërimit në secilën degë të kompanisë në ditën e fundit të vitit me 31 dhjetor. Ekipet e numërimit kanë përgatitur regjistrat e detajuar të numërimit të cilat pastaj janë vlerësuar nga personeli i EuroTar. Në katër vitet e fundit auditorët kanë marrë pjesë në numërim në gjashtë degë të kompanisë. Degët janë përzgjedhur në mënyrë të rastësishme çdo vit por për shkak se klienti i auditimit është shumë i ndjeshëm në rritjen e tarifës së auditimit, auditorët kishin vendosur të zgjedhnin vetëm degët që nuk ishin më larg se 1 orë vozitje nga Prishtina. Janë gjithsej 19 degë/dyqane në atë zonë gjeografike. Për auditimin e këtij viti është vendosur që auditorët të vizitojnë edhe dy degë që janë më të largëtat nga Prishtina dhe 5 të tjera në distancën normale të udhëtimit. Personeli i auditimit që duhej të udhëtonte në ato 2 pika të largëta, kishte udhëtuar në datën 31 dhjetor dhe duhej po ashtu të kalonin natën në hotel për tu kthyer ditën e nesërme. Ky fakt e rriti për pak tarifën e auditimit por është konsideruar se do të ofronte dëshmi shtesë të auditimit këtë vit. Në vijim janë paraqitur raportet e personelit të auditimit të cilët kishin marrë pjesë në numërimin e stoqeve për vitin 2017 në degët të cilat në vitet e kaluara nuk kishin marrë pjesë në numërim.

Raporti 1

Unë morra pjesë në numërimin e stoqeve në degën e Dragashit me 31 dhjetor 2017. Dyqani është mbyllur në orën 18:00 (zakonisht mbyllet në orën 21:00) për të lehtësuar numërimin. Numërimi u krye nga kompania e specializuar për numërim. Numërimi filloj rreth orës 18:30 dhe përfundoi rreth orës 23:30. Unë kam qëndruar në dyqan gjatë gjithë kohës; kam vëzhguar numërimin dhe i kam kryer detyrat tjera siç janë paraparë në programin e auditimit. Detajet e testeve specifike të kryera janë të bashkangjitura në dosjen e auditimit. Në përfundim, nuk kam vërejtur diçka që do të sugjeronte se numërimi nuk është kryer si duhet dhe se shifrat që rezultojnë nga numërimi janë të besueshme dhe janë të sakta.

Betina, juniore e auditimit

23-01-2018

Raporti 2

Unë kam marrë pjesë në numërimin e stoqeve në degën e Kamenicës. Numërimi është kryer nga kompania e specializuar për numërim. Kanë qenë katër numërues. Këta numërues kanë punuar në qifte dhe u është nevojitur përafërsisht tre orë të përfundojnë numërimin. Numëruesit e kompanisë së specializuar ishin të shoqëruar nga menaxheri i degës, i cili vepronte si mbikqyrës dhe nga dy shitës të dyqanit të cilët ndihmonin në lokalizimin dhe identifikimin e artikujve. Nuk isha në tërësi i kënaqur me procedurat e numërimit të ndjekura nga kompania e specializuar e numërimit. Ata nuk hapën asnjë nga pakot, as në bazë të mostrës. Të gjitha stoqet në grumbull ishin futur në kuti kartoni dhe mbeten të pakontrolluara përveç konfirmimit të numrit të kutive. Po ashtu, personeli i numërimit nuk i shikonte afatet e skadencës së produkteve përveç atyre që i kishin shumë afër. Menaxheri i dyqanit i siguronte numëruesit se punëtorët e dyqanit i rradhisin produktet e freskta prapa produkteve që kishin afat më të afërt të skadencës, prandaj produktet që kishin afat të afërt të skadencës ishin të vendosura përpara në raftë. Unë ë ngrita këtë çështje me personelin e kompanisë së specializuar të numërimit duke ju tërhequr vëmendjen se ata po shkelnin procedurat a numërimit dhe se ishin duke dështuar të kryenin punën. Numërimi nuk po kryhej sipas procedurave që ndjekeshin vitet e mëparshme. Përgjigja e tyre ishte se do të merrte shumë kohë për dy qifte numëruesish të kryenin punën sipas mënyrës që sugjeroja unë.

Mati, Audit Senior

01-01-2018

Kërkohet:

- (a) Analizoni në mënyrë kritike rreziqet e auditimit në të dy nivelet, në atë të pasqyrave financiare dhe në nivelin e pohimit (ose gjendjes së llogarisë) lidhur me auditimin e EuroTar. (13 pikë)
- (b) Kritikoni qasjen e auditorëve në auditimin e stoqeve për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2017 si dhe vitet e mëparshme. (12 pikë)
- (c) Rekomandoni punën shtesë relevante lidhur me pohimin e ekzistencës për stoqet, punë kjo që është e nevojshme për të përfutur dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017. (10 pikë)

(Gjithsej 35 pikë)

Zgjidhja

(a)

Rreziku i vetëvetishëm dhe i kontrollit:

(i) Ky është një shitës me pakicë me vëllim të madh që operon me marzha relativisht të ulëta në një industri mjaft konkurruese. Kjo kompani mund të jetë e ndryshme në ndryshimet nga jashtë siç janë luhatja në normat e këmbimit valutor. Gjithashtu në ndryshimet e modës të cilat mund të shkaktojnë tepricë në stoqe.

(ii) Është biznes me para të gatshme prandaj është i ndryshëm ndaj keqpërdorimit dhe gabimeve në regjistrime. Në këtë aspekt nevojiten kontrole të forta për të siguruar se regjistrat e kontabilitetit për parane janë të sakta dhe të plota.

(iii) Ka gjithmonë një obligim për vlerësim të saktë të stoqeve. Keqpërdorimi i stoqeve nga stafi ose nga blerësit është një rrezik evident për shkak të vlerës së vogël të njësive të stoqeve.

(iv) Ka mundësi që dyqanet punësojnë numër të lartë të punonjësve me orar të pjesshëm dhe me pagë minimale. Kontrolli mbi këta persona mund të jetë më i vështirë për shkak se punonjësit mund të mos çajnë kokën nëse shkarkohen ose jo nga puna. Në nivelin e saldoshës së llogarisë, llogaritë me rrezikun më të madh mund të jenë stoqet, paraja dhe llogaritë e pagueshme. Plotësia e llogarive të pagueshme mund të jetë çështje serioze sidomos nëse degët kanë llogari të hapura direkt me furnitorët. Do të nevojiten kontrole më strikte për të siguruar se ka vlerësim të duhur në pasqyrat financiare.

Rreziku i moszbulimit

Klienti duket që është tejte i ndryshëm në tarifën e auditimit. Kjo shkakton rritjen e rrezikut të moszbulimit pasi që auditori është gjithmonë i brengosur që kosto e auditimit të mbulojë punën që duhet të kryhet gjatë auditimit.

(b) Qasja në auditimin e stoqeve duket se është e diskutueshme në vitin e mëparshëm. Janë gjithsej 47 dyqane dhe edhe pse nuk është përmendur në rast, ka gjasë që madhësia e tyre të jetë e ngjashme. Në secilin nga 4 vitet e mëparshme auditorët kanë vetëm gjashtë numërime secilin vir të cilat ndoshta përfaqësojnë vetëm 10-20% të stoqeve totale. SNA 501 Dëshmitë e auditimit – konsideratat specifike për zërat e zgjedhur kërkon që auditori të marrë pjesë në numërimin e stoqeve, edhe pse kjo nuk do të thotë që numërimi të mbulojë 100% të stoqeve, mospjesëmarrja në numërim të 80-90% të stoqeve duket mjaft e diskutueshme. Ky rrezik zvogëlohet deri diku me përdorimin e kompanisë së specializuar për numërimin e stoqeve nëse ka një ekip të fortë të auditimit të brendshëm. Një mangësi tjetër në vitet e mëparshme është fakti se degët më të largëta nga Prishtina nuk janë vizituar fare.

Situatata këtë vit është përmirësuar pak – tani auditorët janë duke marrë pjesë në shtatë degë dhe janë duke u mbuluar edhe degët që nuk janë në afërsi të zyrave të auditorëve. Ende mund të ketë çështje të diskutueshme nëse niveli i mbulueshmërisë së stoqeve është i mjaftueshëm por gjithsesi është më i mirë se vitet e mëparshme.

Duket se seniori i auditimit ka zbuluar çështje specifike në degën e Kamenicës. Kjo mund të jetë tregues se numërimi nuk është duke ofruar dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit lidhur me stoqet. Duhet të theksohet se kjo deklaratë vjen nga seniori i auditimit (zakonisht ky është personeli më senior në ekip të auditimit).

Raporti nga Dragashi është mjaft i dobët dhe tregon se nuk ka pasur vështirësi. Mirëpo, ky raport është dorëzuar nga një junior i auditimit i cili mund të mos ketë përvojën e duhur dhe mangësi në skepticizmin profesional për këtë proces. Përveç kësaj, raporti është datuar 3 javë pas pjesëmarrjes në numërim dhe arsyeja për vonesë në raportim duhet të hetohet.

(c) Për arsye të shumta tani është evidente se kemi çështje serioze lidhur me ekzistencën dhe vlerësimin e stoqeve. Së pari duhet të konsiderojmë pozitën kundrejt degës së Kamenicës. Në këtë rast duhet të kryhet punë shtesë e auditimit për tu siguruar se ato rreziqe janë adresuar. Seniori i auditimit nuk është i sigurt nëse janë stoqet janë mbivlerësuar për shkak të moshapjesë së kutive të kartonit dhe po ashtu nëse stoqet në raftet e dyqanit do të mbesin të pasitura brenda afatit të skadencës. Këto çështje mbesin të hapura për të gjitha dyqanet në zonat më të largëta nga Prishtina të cilat nuk janë vizituar fare.

Hapi i parë është grumbullimi i dëshmive nga sa më shumë burime. Për shembull, sistemi i meenaxhimit të stoqeve të kompanisë duhet të jetë i aftë të gjenerojë informata të dobishme për procedura analitike në mënyrë që seniori i auditimit të mund të adresojë këto çështje edhe në dyqanet tjera. Ai duhet të identifikojë dyqanet që kanë stoqe që lëvizin ngadalë që në përgjithësi do të thotë se stoqet përfundimtare mund të jenë të mbivlerësuar. Gjithashtu duhet të analizohet më tutje nëse numërimi është kryer nga personel i mjaftueshëm.

Duhet të ketë vizita shtesë në dyqanet e numëruara për tu siguruar se numërimi është në përputhje me gjendjen përfundimtare të raportuara.

Vizitat e organizuara gjithashtu duhet të adresojnë çështjen e kutive të pahapura dhe kjo të bëhet sa më shpejtë pa e informuar më herët menaxherin e dyqanit.

Duhet të ketë krahasim të detajuar me vitin e maparshëm me buxhete dhe parashikime dhe me mesataren e industrisë. Në një biznes me pakicë duhet të ketë informata të mjaftueshme për të krahasuar. Luhajtja në fitimin bruto me vetëm 0.5% në 5 vitet e fundit si dhe çfardo luhajtje tjetër duhet të hetohet në tërësi.

Detyra 2

Kompania Lili Shpk ka pasur të hyra prej €10 milion dhe fitim prej €1.5 milion për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2016. Mirëpo, kontabilisti i kompanisë ishte përjashtuar nga puna për shkak të keqpërdorimit të fondeve të kompanisë. Mashtrimi ishte kryer brenda pesë muajve gjatë vitit 2016, gjatë së cilës periudhë kontabilisti kishte pasur marrëveshje të fshehtë me njërin nga shitësit e kompanisë dhe me njërin nga personelin e agjencisë së pavarur për mbledhjen e borxheve në emër të Lili Shpk. Kontabilisti së bashku me këta persona kishte keqpërdorur €55,000 të pranuar nga afër 1,900 konsumatorë të Lili Shpk.

Mashtrimi ishte zbuluar gjatë një bisede biznesore në mars të vitit 2017, kur drejtori ekzekutiv i Lili Shpk kishte organizuar një drekë zyrtare me konsumatorët e kompanisë.

Drejtorët e Lili Shpk janë të sigurt se auditori i kompanisë ishte neglizhent gjatë punës pasi që kishte dështuar të zbulonte mashtrimin gjatë kohës së auditimit të pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2016.

Auditorët theksuan se secili sistem i kontrollit të brendshëm i kompanive ka disa kufizime të vetëvetishme prandaj refuzojnë pretendimet se ishin neglizhent gjatë auditimit. Ata po ashtu pretendojnë se çfardo rishikimi i pavarur i letrave të punës së tyre do të konfirmonte se ata nuk ishin neglizhent gjatë kryerjes së auditimit.

Kërkohet:

(a) Vlerësoni kufizimet e vetëvetishme në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe gjithashtu edhe në procesin e auditimit. Konsideroni pse këto kufizime mund të rezultojnë me mos zbulimin e mashtrimit edhe nëse auditimi është kryer si duhet, ngjashëm sikur në rastin e mësipërm. (15 pikë)

(Gjithsej 15 pikë)

Zgjidhja

(a) Kufizimet në procesin e auditimit janë listuar më poshtë:

Kufizimet e vetëvetishme

Për shkak të kufizimeve të vetëvetishme të auditimit, auditorët mund të ofrojnë vetëm 'siguri të arsyeshme' mbi paraqitjen e drejtë dhe të sinqert të pasqyrave financiare dhe jo një siguri absolute.

Përdorimi i gjykimit profesional

Auditimi përfshin përdorimin e gjykimit në identifikimin e rreziqeve të auditimit, përzgjedhjen e procedurave të përshtatshme të auditimit dhe interpretimin e dëshmive të auditimit. Edhe pse standardet e auditimit ofrojnë udhëzues për ti ndihmuar auditorëve në formimin e një gjykimi solid profesional, është e pashmangshme që një auditor të gjykojë gabimisht një situatë që shkakton moszbulimin e ndonjë anomalie materiale në pasqyra financiare.

Përdorimi i mostrimit

Auditorët përdorin teknika të mostrimit për të limituar numrin e transaksioneve dhe saldoeve të përzgjedhura për të testuar në mënyrë që auditimi të kryhet me efektivitet dhe efikasitet. Rezultatet që dalin nga transaksionet dhe saldot e përzgjedhura mund të mos jenë përfaqësuese të popullatave. Prandaj ka një rrezik të vetëvetishëm që procedurat e auditimit të dështojnë të zbulojnë një anomali materiale në pasqyrat financiare për shkak të pamundësisë së auditorëve të kryejnë teste të detajuara në të popullatën e transaksioneve dhe saldoeve.

Përfaqësimet e menaxhmentit

Në përgjithësi, dëshmitë e jashtme konsiderohen më të besueshme se ato të pranuar nga brenda (të gjeneruara nga menaxhmenti). Edhe pse auditorët mbledhn dëshmi të auditimit nga një gamë e burimeve, shumë shpesh ata duhet të mëbshteten në përfaqësimet nga menaxhmenti për të vlrësuar arsyeshmërinë e çështjeve lidhur me pasqyrat financiare. Kjo është shumë e rëndësishme sidomos për çështjet që përfshijnë përdorimin e gjykimit nga menaxhmenti pasi që zakonisht është vështirë të merren dëshmi vërtetuese për ato gjykime nga palët e jashtme. Rreziku nga mashtrimi për nga natyra është vështirë të zbulohet sidomos nëse ka marrëveshje të fshehta edhe nëse pëdoren procedura shumë të mira të auditimit.

Pengesat kohore

Në praktikë auditorët ballafaqohen me pengesa kohore brenda të cilave duhet të ofrojnë opinionin e tyre mbi pasqyrat financiare. Auditorët kanë tendencë të ju japin përparësi detyrave që janë esenciale për performancën efektive të auditimit. Në disa raste, sidomos kur kompanitë ballafoqohen me kërkesa ligjore për publikimin e pasqyrave financiare të audituara në datë të caktuar, auditorët mund të dështojnë të konsiderojnë të gjitha fushat me rrezik duke ndjekur afatet kohore.

Kërcënimet e pavarësisë

Ndërsa udhëzuesit e etikës të publikuar nga IFAC dhe organizatat tjera profesionale tentojnë të minimizojnë rastet kur mund të dëmtohet objektiviteti i auditorëve, disa konflikte të interesit në praktikë janë të pashmangshme. Pavarësia e perceptuar e auditorit do të dëmtohet nëse të hyrat nga një klient përmbëjnë një përqindje të madhe të të hyrave të auditorit..

Mbështetja në kontrollet e brendshme

Në shumicën e auditimeve, auditorët mbështeten në sistemet e kontrollit të brendshëm si burim kritik i dëshmive të auditimit. Mirëpo, sistemet e kontrollit të brendshëm kanë kufizime të vetëvetishme siç janë:

Shumica e sistemeve të kontrolleve të brendshme mbështeten në ndarje të detyrave të cila mund të anashkalohen përmes marrëveshjeve të fshehta në mes të punonjësve se në mes të punonjësve dhe personave të jashtëm.

Kontrollet e brendshme shpesh mbështeten në kontrolle të dyfishta, por edhe kontrollet e dyfishta mund të përmbajnë gabime njerëzore.

Kontrollet e brendshme janë të dobishme vetëm nëse janë efektive nga aspekti i kostos, prandaj nuk do të ishte mençuri nëse tentohen të ndalohen të gjitha gabimet dhe mashtrimet.

Kontrollet e brendshme në mënyrë tipike janë të disenjuara të trajtojnë transaksione rutinore që përsëriten, prandaj transaksionet jorutinore dhe të jashtëzakonshem mund të mos i nënshtrohet kontrolleve të duhura.

Kontrollet e brendshme ndonjëherë mund të anashkalohen nga menaxhmenti dhe atë në mënyrë specifike në organizata më të vogëla dhe organizata joqeveritare. Në rastin tonë do të ishte e vështirë për auditorët të zbulonin keqpërdorimin e fodeve për arsye në vijim:

Shuma e mashtrimit është jomateriale në kontekstin e biznesit që është përafërsisht 3.67% e fitimit neto dhe 0.55% e të hyrave. Prandaj nuk do të ishte evidente në procedurat analitike të pasqyrave financiare.

Nuk kemi njohuri se si është kryer mashtrimi ose shtrirja e mbulimit nga kontabilisiti por nëse 55,000 Euro janë të shpërndara në mënyrë të barabartë në 1,900 konsumatorë shuma që flasim për secilin konsumator është €29, në këtë kontekst shumat individuale janë të parëndësishme për të tërhequr vëmendjen e auditorit

Mashtrimi është kryer në vitin që përfundoi në dhjetor 2016 dhe është zbuluar në mars 2017. Kjo është relativisht periudhë e shkurt dhe nuk është e qartë nëse auditimi është finalizuar deri në kohën kur është zbuluar mashtrimi

Na është thënë se mashtrimi është kryer përmes marrëveshjeve të fshehta dhe e dimë që marrëveshjet e fshehta mund të minojnë shumicën e kontrolleve të brendshme sepse ato sisteme bazohen kryesisht në ndarje të detyrave

Në anën tjetër duket se janë dy anë të marrëveshjeve të fshehta, njëra me shitësin dhe tjetra me agjencinë për grumbullimin e borxheve. Ky është një rast i mashtrimit që duket shumë i vështirë për tu zbuluar.

Detyra 3

Ju jeni udhëheqës i një ekipi të vogël që kryen kontrollin e cilësisë brenda firmës SS-Audit. Ekipi juaj është angazhuar të kryej 'rishikim të ftohtë' të dosjeve të auditimit me fokus në çështjen se sa janë përmbushur kërkesat për të grumbulluar 'dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit' siç kërkohet nga *SNA 500 – Dëshmitë e auditimit* si dhe nga udhëzuesit e brendshëm të firmës.

Ekipi juaj ka raportuar për çështjet në vijim të cilat duhet të trajtohen më tutje nga ju:

(a) Gjatë auditimit të ciklit të prodhimit në KosPro, auditori kishte përzgjedhur katër urdhërblerja lidhur me lëndën e parë dhe ka ndjekur secilën urdhërblerja deri në sistemin e kontabilitetit prej fillimit deri në fund. Ai ekzaminoi kërkesën për blerje dhe fletëpranimin e mallit nëse kanë iniciale të nënshkrimit nga personi përgjegjës, faturën e furnitorit (që ishte stampuar 'E paguar'), kërkesën për pagesë dhe fletë-trasferin e bankës. Si rezultat i kësaj pune, auditori shënoi në letrat e punës se nuk ishte shumë i njoftuar me sistemin e pagesave për ciklin e prodhimit megjithatë ishte konfident se kuptonte pyetjet në formën e vlerësimit të kontrolleve të brendshme, të cilën më vonë e plotësoi në tërësi. (7 pikë)

(b) Kompania Lio Shpk kishte blerë shtatë artikuj material të pasurive joqarkulluese me lizing financiar gjatë vitit. Eminja, menaxhere e auditimit konfirmoi obligimin për secilin lizing me kompaninë lizingdhënëse, i studio me kujdes te shtatë marrëveshjet e lizingut dhe i ndjeki të gjithat regjistrimet në kontabilitet. (6 pikë)

(c) Në përfundimin e auditimit të CMN ShA, Mali, senior i auditimit e mori një letër të përfaqësimit ashtu siç kërkohet me *SNA 580 – Përfaqësimet e shkruara* nga menaxheri senior i kompanisë, menaxheri i financave dhe kontabilisti i kompanisë. Ai nuk kishte kërkuar konfirmime të shkruara nga kryesuesi i bordit të kompanisë as nga drejtori ekzekutiv dhe nga drejtori financiar edhe pse ai kishte punuar afër me këta persona gjatë auditimit dhe kishte përftuar informata të dobishme nga ata. (6 pikë)

(d) Toma auditoi llogarinë e riparimeve dhe mirëmbajtjes të kompanisë Uoli Shpk (materialiteti i angazhimit €75,000) duke i ndjekur të gjitha regjistrimet më të larta se €5,000 (gjithsej €315,000) deri te dokumentet mbështetëse. Ai llogariti shumën e të gjitha regjistrimeve të mbetura në vlerë prej €80,000 dhe vendosi se shumat ishin të arsyeshme dhe nuk kreu asnjë procedurë shtesë të auditimit lidhur me ato regjistrime. (6 pikë)

Kërkohet:

Shkruani një memo për ekipin tuaj në të cilin vlerësoni se deri në çfarë mase ekipet e auditimit nga skenarët e mësipërm kanë kryer punën e auditimit në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Ofroni çfardo informate shtesë që ju konsideroni se është e duhur për secilin rast.

(Gjithsej 25 pikë)

Zgjidhja

Për: Ekipin e kontrollit të cilësisë

Nga: udhëheqësi i ekipit

Data: sot

Shënime

Ju falemnderit për raportin tuaj lidhur me çështjet e ndryshme që kanë të bëjnë me auditimin dhe procedurat në firmën tonë. Më poshtë janë komentet për secilin rast:

(a) Në këtë rast duket se auditori ka kryer teste 'hap-pas-hapi' si pjesë e ekzaminimit të ciklit të prodhimit. Testet hap pas hapi përfshijnë ndjekjen e transaksioneve nga inicimi deri në përfundim me qëllim të konfirmimit të njohurisë së auditorit për sistemet dhe për mjaftueshmërinë e sistemeve përfshirë diagramet e kontrollit të brendshëm. Auditori ndjek katër transaksione të tilla që do të ishte një numër i përshtatshëm për testim hap-pas-hapi. Problemi është se auditori duket se nuk u bazuar në këtë rezultat për të plotësuar pyetësorin e kontrollit të brendshëm. Kjo do të duhej të plotësohej vetëm pasi që auditori të kishte informata më të plota përveç testimit të katër transaksioneve. Pyetësorët e kontrolleve të brendshme mulojnë një gamë të gjërë të kontrolleve, prandaj për të plotësuar si duhet duhet të shikohen aspekte të ndryshme të kontrolleve dhe të testohen.

(b) Eminja duket se ka bërë mjaft sa pritet në mënyrë të arsyeshme nga ky rast. Është e vlefshme të qartësohen edhe çështjet në vijim:

- Një përfaqësim i shkruar nga menaxhmenti sa i përket faktit që qiradhënësi është palë e palidhur nga kompania. Kjo shpesh është e panevojshme nëse është kompani e njohur.
- Inspektimi fizik i pasurisë së përfutur me lizing
- Vlerësimi i përshtatshmërisë së trajtimit të lizingut sipas SNRF
- Konfirmimi i shkruar nga menaxhmenti se nuk ka ndonjë transaksion tjetër përveç atyre që janë audiuar.

(c) Çështja këtu është se kush duhet të nënshkruaj përfaqësimin e shkruar nga menaxhmenti. Kjo çështje është adresuar në SNA 580 ku thuhet se letra duhet të nënshkruhet nga personat e ngarkuar me qeverisjen para menaxhmentit. Kjo përcakton që përgjegjësia përfundimtare për pasyqrat financiare është te personat e ngarkuar me qeverisjen. Prandaj, është e mjaftueshme të kemi përfaqësime të shkruara nga personat e ngarkuar me qeverisjen dhe ndoshta është e mjaftueshme që letrën ta nënshkruajnë edhe menaxheri senior i kompanisë, menaxheri i financave dhe kontabilisti i kompanisë mirëpo duhet të theksohet se ata po e nënshkruajnë në emër të bordit të drejtorëve.

(d) Auditimi i riparimeve dhe mirëmbajtjes mund të përmbaj rrezik për auditorin pasi që klienti mund të përpiqet ose të fryjë fitimin duke u përpjekur të kapitalizojë zërat që do të duhej të paraqiteshin si shpenzime ose e kundërta duke shpenzuar zërat e pasurive. Secila nga anomalitë do të ketë po ashtu edhe ndikime tatimore.

Në këtë rast auditori duket se ka bërë punë të arsyeshme. Ai ka ndjekur faturat të cilat përfaqësojnë 80% të shpenzimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes prandaj mund të supozohet se nuk ka shpenzim të vetëm që është 1.3% i shpenzimit total. Si testim i pavarur ky duket se është i mjaftueshëm. Mirëpo ndoshta është dashur të bëhen edhe teste tjera rreth kësaj fushe, psh të testohen shtesat në pasuritë joqarkulluese për të krahasuar me shpenzimet e riparimit dhe mirëmbajtjes nëse janë klasifikuar gabimisht.

Detyra 4

(a) Krahasoni dhe bëni dallimin në mes të përgjegjësive të menaxhmentit dhe përgjegjësive të auditorëve lidhur me vlerësimin e parimit të vijimësisë. Duhet të përfshini përshkrimin e procedurave të përdorura në vlerësim. (5 pikë)

(b) Ju jeni menaxher i auditimit në firmën D-Audit, dhe jeni përgjegjës për shpërndarjen e personelit në tre auditime të pasqyrave financiare të kompanive të mëposhtme për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017:

1. Arta Shpk është klient i ri. Kjo kompani është prodhuese dhe shpërndarëse e pajisjeve sportive. Drejtori financiar i kompanisë, Petriti, nuk është i bindur se ka vlerë të madhe auditimi i kompanisë prandaj edhe kishte hapur tenderin për firmë të auditimit duke dashur kështu të gjejë një kompani më të lirë se auditori i vitit të kaluar. Në pajtueshmëri me kërkesat e tenderit, firma juaj kishte paraqitur në ofertë se nuk do të ketë auditim të ndërmejtëm.

2. Blerta Shpk, një klient afatgjatë, operon me një zingjir të supermarketeve në tërë vendin. Firma juaj i ka ofruar këshilla financiare për tu listuar në bursë në vitin 2016. Menaxhmenti i lartë është duke pritur një ekzaminim të detajuar të sistemit të kompjuterizuar të kompanisë dhe po ashtu janë duke kërkuar siguri që raporti vjetor nuk do të tërheqë kritika të këqija.

3. Dita Shpk është klient i auditimit që nga viti 2007 pasi që firma juaj e kishte këshilluar menaxhmentin për një blerje/shkrirje. Dita ofron shërbime të komunikimit dhe softuer. Firma juaj i ofron kompanisë Dita këshilla mbi raportimin financiar dhe shërbime të tatimeve. Tash së voni nga ju është kërkuar të ofroni edhe shërbime të vlerësimit për një blerje të mundshme të një kompanisë.

Kërkohet

Për këto angazhime diskutoni:

- (i) Kërcënimet e pavarësisë
- (ii) Çështjet tjera profesionale dhe praktike që mund të shfaqen në këto raste
- (iii) Implikimet lidhur me shpërndarjen e personelit në rastet e mësipërme (20 pikë)

(Gjithsej 25 pikë)

Zgjidhja

(a) Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe auditorëve sa i përket vijimësisë

SNK 1

SNA 570 *Vijimësia* diskuton përgjegjësitë e menaxhmentit dhe auditorëve sa i përket supozimit të vijimësisë. Përshkruan përgjegjësitë e menaxhmentit sa i përket vijimësisë. Hollësitë janë paraqitur në SNK 1 *Paraqitja e pasqyrave financiare*. Ky standard kërkon që menaxhmenti të bëjë vlerësim të aftësisë së entitetit të vijojë sipas supozimit të vijimësisë. Nëse menaxhmenti bëhet i vetëdijshëm për pasiguri materiale që shkaktojnë dyshim në aftësinë e entitetit të vijojë së ekzistuari, kjo duhet të shpaloset. Menaxhmenti po ashtu duhet të shpalos nëse pasqyrat financiare nuk janë përgatitur sipas supozimit të vijimësisë, bazën sipas të cilës janë përgatitur dhe arsyen.

Auditori është përgjegjës për përfitim të dëshmitë të mjaftueshme për përshtatshmërinë e përdorimit të supozimit të vijimësisë nga menaxhmenti në pasqyrat financiare. Bazuar në dëshmitë e mbeldhura, auditori duhet të konkludoj nëse ka pasiguri materiale për aftësinë e entitetit të vijojë së ekzistuari dhe të përcaktojë nëse ka implikime për raport të auditimit.

Prandaj, përgjegjësia kryesore e menaxhmentit është vlerësimi i aftësisë së entitetit të vijojë sipas supozimit të vijimësisë, përdor bazën e saktë të prezentimit të pasqyrave dhe të bëjë shpalosjet e duhura. Auditori do të jap një opinion nëse menaxhmenti e ka përmbushur këtë obligim.

Indikatorët

Edhe menaxhmenti dhe auditorët përdorin një gamë të indikatorëve për të vlerësuar supozimin e vijimësisë. Ata do të shikojnë indikatorët financiar, siç janë koeficientët kyç financiar, dhe po ashtu edhe indikatorët operativ, psh dalja në skenë e një konkurrenti të madh. Përdorimi i indikatorëve nga menaxhmenti është pjesë e punës së tyre të përditshme.

Procedurat

Nga auditorët kërkohet të kryejnë procedura shtesë nëse ngjarjet ose kushtet janë identifikuar dhe paraqesin dyshim për aftësinë e kompanisë të vijojë së ekzistuari. Disa procedura përfshijnë:

- Kërkesa ndaj menaxhmentit të bëjë vlerësimin e supozimit të vijimësisë nëse nuk është bërë ende nga ata
- Vlerësimi i planeve për të ardhmen nga menaxhmenti sa i përket vlerësimit të vijimësisë
- Nëse menaxhmenti ka përgatitur parashikimin e rrjedhës së parasë dhe nëse kjo është domethënëse, duhet të vlerësohet besueshmëria e të dhënave dhe supozimeve të përdorura për këtë parashikim
- Konsiderimi i fakteve ose informative të cilat janë në dispozicion që nga vlerësimi i menaxhmentit
- Kërkesa për përfaqësime të shkruara nga menaxhmenti sa i përket planeve të tyre për veprimet në të ardhmen dhe arsyeshmëria e këtyre planeve
- Nga menaxhmenti nuk kërkohet të kryhen procedura shtesë nëse ka dyshim se entiteti mund të vijojë operimin.

Koha

Sipas SNA 570, auditori duhet të ketë vëmendje përgjatë tërë auditimit për dëshmi ose ngjarje që mund të shkaktojnë dyshim për aftësinë e entitetit të vijojë së ekzistuari. Ngjashëm, menaxhmenti duhet të konsideroj supozimin e vijimësisë në bazë të vazhdueshme. Auditori mbulon periudhën e njëjtë si menaxhmenti në vlerësimin e vijimësisë nga menaxhmenti.

(a) **Kërcënimet e pavarësisë**

Kodi i etikës së IFAC identifikon këto kërcënime: interesin personal, vet-rishikimin, avokimin, familjaritetin dhe frikësimin.

Interesi personal

Interesi personal ka mundësi të jetë çështje për Blerta dhe Dita. Blerta është zingjir i supermarketeve dhe ka mundësi të ofrojë tarifë të lartë për shërbimet e ofruara nga firma se sa Arta. Ngjashëm firma i ofron Dita shumë shërbime përfshirë auditimin, tatimet, kontabilitet dhe shërbimet tjera. Kjo mund të perceptohet si varshmëri e madhe nga tarifat.

Vet-rishikimi

Vet-rishikimi nuk ka mundësi të jetë kërcënim gjatë auditimit të Arta pasi që është klient i ri dhe nuk ka indikacione që firma i ofron edhe shërbime tjera. Në rastin e Blerta dhe Dita, kjo mund të jetë kërcënim pasi që firma ofron shërbime tjera për këta klient.

Nga firma është kërkuar që të rishikojë në detaje sistemin e kompjuterizuar të Blerta. Prandaj duhet të vendosen masa mbrojtëse të përshtatshme për të zvogëluar kërcënimin se ekipi i auditimit është duke vepruar në rolin e menaxhmentit.

Firma ofron Dita këshilla teknike në kontabilitet dhe shërbime tatimore përveç atyre të auditimit. Po ashtu tani kërkohet edhe të bëjë vlerësime për blerjet e mundshme. Duhet të vendosen masa mbrojtëse të përshtatshme për të zvogëluar këtë kërcënim, kjo përfshinë ekipe të ndryshme si dhe të bëhen rishikime të pavarura të punës së ekipit.

Familjaritetit

Nuk ka mundësi të ketë kërcënim të familjaritetit tek Arta, pasi që është klient i ri. Kërcënim të familjaritetit mund të ketë tek Dita dhe Blerta pasi që Dita auditohet që nga viti 2003. Në këtë rrethana është e domosdoshme të zbatohen masa mbrojtëse siç është rotacioni i anëtarëve senior të ekipit ose të ketë rishikime të pavarura të punës së kryer.

Frikësimi

Mund të ketë kërcënim të frikësimit gjatë auditimit të Arta pasi që edhe pse është klient i ri, drejtori finciar nuk she ndonjë përfitim nga auditimi dhe kjo është edhe arsye pse e ka tenderuar shërbimin e auditimit nga viti i kaluar.

Mund të ketë kërcënim të pavarësisë edhe në rastin e Blerta pasi që menaxhmenti është duke kërkuar që raporti vjetor të mos tërheqë kritikë negative.

(b) **Çështjet tjera profesionale dhe praktike**

Për Arta duhet të dërgohet letra e angazhimit për tu caktuar përgjegjësitë e të dy palëve, tarifa dhe koha e kryerjes së auditimit. Pasi që drejtori finciar nuk dëshiron auditim të ndërmjetëm dhe është klient i ri, koha e auditimit do të jetë kyç në këtë angazhim.

Të gjithë këta klient kanë të njëjtën datë të përfundimit të vitit financiar dhe kjo duhet të konsiderohet me kujdes, për shkak të nevojës për staf. Po ashtu pasi që Arta është klient i ri dhe

Blerta është klient i madh, firma duhet të konsiderojë neojën për rishikim të nxehtë nga një partner tjetër për këto angazhime.

Duhet të ketë konsideratë të veçantë për sigurimin e stafit për secilin angazhim. Në rastin e Blerta dhe Dita, si klient afatgjatë, mund të përdoren stafi i viteve të kaluara pasi që kanë përvojë tek këta klient.

(c) **Shpërndarja e personelit**

Kur ofrohen shërbime tjera, firma duhet të sigurojë se anëtarët e ekipit të auditimit nuk janë të përfshirë edhe në shërbimeet tjera, me qëllim të ruatjes së pavarësisë dhe objektivitetit.

Arta është klient i ri i auditimit. Duke marrë parasysh këtë, si dhe sjelljen e drejtorit financiar, firma duhet të sigurojë se për këtë angazhim caktohet një senior me përvojë.

Firma duhet të sigurojë se rishikimi i sistemit të kompjuterizuar të Blerta bëhet nga personeli me përvojë të caktuar pasi që menaxhmenit pret të bëhet një rishikim i detajuar i këtij sistemi.